

Orari i punës / ditët festive

Në Zvicër janë pothuajse të gjitha shitoret në ditën e diel të mbyllura. Përrjashtim bëjnë shitoret në stacionet e trenit. Ditët festive janë të rregulluara me ligj në kantone.

Ditët festive

Ditët festive janë me ligjin për punë të rregulluara dhe të njëta si ditët e diela. Një gushti (dita festive nacionale) është në të gjithë Zvicrën me ligj një ditë festive. çdo kanton mundet edhe tetë ditë të tjera zyrtarisht t'i vendos si ditë festive. Në kantonin Basel-Landschaft ditët festive janë këto festa zyrtare: Viti i ri (1 janar), Karfreitag (e premtja para pashkëve), e hëna e pashkëve, dita e punës (1 maj), ngritja në qiell (e enjte 40 ditë pas të dieles të pashkëve), e hëna e Pashkëve, festa nacionale (1. gusht), Bettag, Krishtlindjet (25 dhjetor), dita e Stefanit (26 dhjetor).

Orari i punës në shitore

Orarët e punës në shitore janë kantonalisht të ndryshme. Në kantonin Basel-Landschaft nuk ka urdhër të shtetit mbi orarin e punës. Shumica e dyqaneve ushqimore janë të hapura nga e hëna në të premtë nga ora 08:00 deri në orën 19:00. Sidoqoftë, kohët mund të ndryshojnë në varësi të dyqanit dhe mund të jenë më të shkurtra ose më të gjata. Të shtunën mbyllen shumica e shitoreve më herët se përgjatë javës. Të dielen janë shumica e shitoreve të mbyllura. Përrjashtim bëjnë shitoret në stacionet e trenave ose pikat e karburantit, që normalisht 7 ditë janë të hapura dhe në të shumtën e rasteve hapen më herët dhe mbyllen më vonë se të tjerat.

Orari i punës në administratën publike

Administra kantonale është sipas rregullit prej të hënës deri të premtën 8.00 deri 12.00 dhe prej 14.00 deri 17.00 e hapur. Disa vende hapen mbasdite prej 13.30 apo janë më gjatë me telefon të arritshme. Orari i punës i administratës nëpër komuna është shumë i ndryshëm. Para s`gjithash në komunat e vogla mundet me qenë orari i punës i kufizuar. Është e këshillueshme në çdo rast, më parë përrmes internetit apo telefonit të njoftohesh për orarin e punës, se kur janë sportelet e hapura.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselland.ch/sq/mire-me-dit/orari-i-punes--ditet-festive